# S T A T U T I

## I SHOQERISE " K U C O V A " Sh.p.k.

Ne Kuçove sot me dt.28.10.1997 ne ortaket themelues:

1-Shezai Barxha, i biri i (Dajkos) i dtl. 1939 banues ne Kuçove.
2- Vasil Daka, i biri i Janit i dtl. 1962 " ne Kuçove.
3 -Artan Vrusho, i biri i Tajarit i dtl. 1962 " " "
4- Dashnor Mimani, " i Mimanit i dtl. 1966 " " "
5- Skender Avdullai" i dtl. 1956 " " "
6-Pellumb Veizi " Qaniut i dtl.1954 " " "
7- Qani Veizi " i dtl.1928 " " "
8-Comen Nuhu " Iljazit i dtl.1952 " " "
9-Arben Nuhu " Skenderit i dtl.1967 " " "
10- Ilir Jaupi " Haxhiut i dtl.1967 " " ".

vendosem te themelojme shoqerine e perbashket private me pergjegjesi te kufizuar Sh.p.k. "K U C O V A "duke patur kete statut;

### N E N I 1

Shoqeria e perbashket private e themeluar nga ortaket Hamza Barxl Vasil Daka,Artan Vrusho,Dashnor Mimani,Skender Avdullai,Pellumb Veizi, Qani Veizi,Comen Nuhu,Arben Nuhu,Ilir Jaupi eshte Shoqeri Transporti Udl taresh Interurban me pergjegjesi te kufizuar.

### N E N I 2

Emri i shoqerise eshte "K U C O V A ".

Shoqeria e ka seline ne Kuçove dhe e kryen veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqipeirse dhe jashte saj.

### N E N I 3

Shoqeria "KUCOVA" eshte person juridik dhe fiton zotesi te plote per te vepruar nga data e rregjistrimit ne Gjykatene Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

### N E N I 4

Shoqeria do te vazhdoje aktivitetin e saj per me shume se 10 vjet.

### N E N I 5

Objektivi i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete:

Transporti interurban i udhetareve dhe i bagazheve tetyre ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

% % %

## NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000(njeqind mije) leke, kontribut i te gjithe ortakeve themelues ne pjese te barabarta.

Shoqeria ka ne Banken Kombetare Tregetare Kuçove Llogarine e saj rrjedhese ne emrin e saj.

## NENI 7

Ortaket kane te drejte te zmadhojne kapitaline e tyre si ne natyre ashtu dhe ne vlere. Ne kete rast behen veprimet perkatese si per pjesemarrje e ortakeve ne, kapitalin themeltar. Ortaket kane te drejte te zvogelojne kapitalin e tyre , e ky zvogelim behet ne proporcion te drejte me masen e kontributit ne kapitalin themeltar.

## NENI 8

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie e ndermjet bashkeshortve dhe ndermjet ortakeve. Ne çdo rast transferimi i kapitalit themeltar behet me pelqimin e oratkut tjeter. Per transferimin e kapitalit themeltar personave te trete ortaku ka te drejten e parablerjes. Per kete ortaku njoftohet me shkrim. Mbas kalimit kalimit te afatit tremujor nga dita e njoftimit transferimi i kapitalit i behet personit te trete, ne rast se brenda keti afati ortaku nuk e ble kapitalin. Transferimi i kapitalit behet m akt noterial.

## NENI 9

Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, penglenesi pranohet si person e i transferohen pjeset e kapitalit me perjashtim te rasteve kur shoqeria i blen pjeset.

## NENI 10

Organet e shoqerise jane Asamblea e Ortakeve dhe Administratori.

## NENI 11

Vendimet merren nga Asamblea. Ato mund te merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve ne rast se ortaket e miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit.

## NENI 12

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Vendime e disponon nje numer te barabarte votash me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter ose nga nje pesron tjeter kur per kete ka nje autorizim me shkrim te vertetuar nga Noteri..

## N E N I 1 3

Mbledhja e Asamblese thirret kur kete e kerkon qofte dhe njeri prej ortakeve.

## N E N I 1 4

Vendimet e Asamblese merren me shumice votash.

## N E N I 1 5

Asamblea e ortakeve vendos per keto çeshtje:

-Zgjedhja e personit qe do te drejtoje shoqerine (Administratorin)

-Emeron ekspertin kontabel.

-Vendos per prishjen e shoqerise.

-Ben ndryshime ne statut.

-Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar.

-Vendos per shkrirjen e shoqerise ne shoqeri te tjera.

-Ne rastet e prishjes se shoqerise cakton likuidatorin dhe e shkarkon ate kur perfubdon likuidimi.

-Vendos per çdo problem tjeter qe vihet ne rendin e dites.

Vendimet e mesiperme merren me miratimin me shumice votash te ortakeve.

## N E N I 1 6

Shoqeria drejtohet nga Administratori saj i cili eshte Hamza Barxha.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne xemer te shoqates ne marredhenie me te tretet, me perjashtim te komptenecave qe i jane lene Asamblese se ortakeve.

## N E N I 1 7

Administratori ka te drejten e firmes. per probleme te veçanta Administratori autorizon per te perfaqesuar ate dhe nje person te trete.

## N E N I 1 8

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administrimit dhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Por shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin se akti i administratorit e kalonte objektivin e shoqerise, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

## N E N I 1 9

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj te treteve, per shklejen e ligjeve, per shkelje te statutit

ose per fajet e kryera gjate administrimit te shoqerise.perveç padise per shlyerjen e demit, ortaket kane te drejte te ngrene padi penale kund administratorit.

## N E N I 2 0

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

- administrimin e shoqerise ne perputhje me kontraten e statutit. pjesmarrjen me rezultate te çdo forme te veprimtarise se shoqerise te parashikuar ne kontrate e statut.
- marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise si dhe çdo lloj tjeter dokumentacioni qe ka lidhje me ushtrimin e veprimtarise nga ana e shoqerise.
- secili ortake ka te drejte te heqe dore nga shoqeria,por pasi te kete vene ne dijeni asamblene per kete veprim me shkrim brenda tre muajve.

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

- te depozitojne kuoten e tyre dhe kuoten suplementare ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- ti japin shoqerise te dhena te mjeftueshme per objektivin lidhur me veprimtarine e shoqerise.
- te kryejne te gjitha detyrat dhe realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.

## N E N I 2 1

Ortaket kane te drejte te caktojne nje ekspert kontabel, neqoftese gjate veprimtarise se tyre do te plotesohen nje nga kushtet e nenit 65te ligjit per shoqerite tregetare.

Ne rast kundershtimi ,çdo ortak ka te drejte te kerkoje ne rruge gjyqesore caktimin e nje eksperti per paraqitjen e nje raporti per nje ose disa veprimtarive administrative.

## N E N I 2 2

Per pasqyrimin e aktivitetit ekonomik te shoqerise, administratori eshte i detyruar te mbaj dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrin perkates sipas ligjit ne fuqi. Ai duhet te paraqes bilance periodike vjetore si dhe deklaraten perkatese te te ardhurave dhe ti depozitoj ne organet financiare juridikisht ku ushtron aktivitetin shoqeria.

## N E N I 2 3

Ushtrimi i veprimtarise se shoqerise fillon me 1 Janar deri me 31 Dhjetor te çdo viti.Ne fund te çdo viti behet inventari i pasurise se shoqeris Perjashtimisht ushtrimi i parei i veprimtarise perfshin periudhen e them

limi ligjor i shoqerise deri ne fundin e vitit 1997.
Pas mbyll es se llogarive eksperti kontabel i autorizuar perpilon situacionin financiar vjetor ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 24

Ne mbyllje te çdo viti financiar ,administratori ben inventarin e llogarit vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim.

Bilancit i bashkangjitet:

a - N e situacion mbi garancit e dhena nga shoqeria.

b - N e situacione mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

Raporti i administratorit perfshin gjendjen gjate vitit financiar te kaluar,ndryshimet e parashikuar, veprimtarit e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri diten qe eshte hartuar ky raport.Dokumentat vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 25

Shoqeria prishet me kalimin e afatit te caktuar ne statut.
Shoqeria prishet para afatit me vendim te asamblese dhe kur njeri nga ortaket heq dore nga shoqeria , i cili ne kete rast duhet te njoftoje ortaket e tjere me shkrim tre muaj para.

NENI 26

Shoqeria nuk quhet e prishur kur kapitalet perqendrohen ne duar te njerit prej ortakeve te vetem.

NENI 27

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimin e ndarjen e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit nefuqi.

NENI 28

Kur shoqeria prishet e kalon ne likuidim, ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi " Shoqeria ne likuidim e siper".Shoqeria edh gjate procesit te likuidimit vazhdon si person juridik deri ne perfundim te procesit te likuidimit.

Prishja e shoqerise eshte[illegible] ndaj te treteve vetemm mbas publikimit te prishjes ne rregjistrin tregetar.

NENI 29

Per te perfunduar procesin e likuidimit ,asambleja emeron nje person e likuidues, i cili perfaqeson shoqerine.Likuidatori perpilon bilancin

financiar ;likuidon tek te tretet detyrimet e shoqerise,shet aktivite e shoqerise dhe ndan tepricat ne disnozicion. Likuidues mund te jete dhe njeri nga ortaket .

Ne rast se ortaket nuk kane mundesi te emerojne nje likuidues , ai emerohet nga gjykata me kerkesen e çdo personi te interesuar.

N E N I 3 0

Ne periudhen e likuidimit ortaket mund te njihen me te gjithe dokumentacionin e shoqerisene te njejtat kushte si me pare.

N E N I 3 1

Kur shoqeria likuidohet ,pasurite qe jane vene ne disnozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi , ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi tu jene bere pagesat.

Mjetet finaciare te fituara si rezultat i veprimatrise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi tu jene paguar pagesat per kreditoret.

N E N I 3 2

Ne perfundim te mbyll es se likuidimit, ortaket le te vendosin per bilancin perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per administrimin nga ana e likuiduesit,dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit si dhe per tu evituar mbylljen e likuidimit.

Dokumentet e mesiperme miratohen nga asambleje ne unaminitet.

N E N I 33

ne rast se ortaket kane mosmarveshje me menyren e likuidimit te shoqerise , keto zgjidhen ne rruge gjyqesore konform ligjeve ne fuqi.

N E N I 3 4

Shoqerija ka te drejte te punesoj punonjes te tjere qe i nevojiten per ushtrimin e veprimtarise se saj.Punesimi behet sipas kushteve te percaktuarane ligjin e punes te Republikes se Shqiperise, dhe rregullave te vena ne kontraten e punesimit qe lidhet midis punedhenesit dhe te punesuarit.Shoqeria u garanton punonjesve kushte pune dhe mjetet e nevojshme per realizimin e detyres se kryer.

N E N I 3 5

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
Ne rast mosmareveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim,kompetente per kete zgjidhje eshte Gjykatat e Shkalles se Pare te rrethit Kuçove.

## N E N I 3 6

Shoqeria çregjistrohet nga rregjistri tregetar pasi kryen te gjitha veprimet dhe formalitete e shperndarjes se saj.

## N E N I 3 7

Persa nuk eshte parashikuar ne dokumentet e kesaj shoqerie, referohet ligjit perkates ne fuqi.

## N E N I 3 8

Ky statut firmoset nga palet me vullnetin e tyre te lire.

Shezai Barxha    Vasil Daka    Artan Vrusho    Pashnor Mimani

Skender Avdullai    Pellumb Veizi    Gani Veizi    Comen Nuhu

Arben Nuhu    Ilir Jaupi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE JONILDA ODRICANI

K U C O V E

Nr_ 941_ i ven.

V E R T E T I M

Sot ne Kuçove me dt.28.10.1997 para meje noteres Jonilda Odriçani u paraqiten personalishte shtetasit e mesiperm,ortakt themelues te shoqrise "KUCOVA"Sh.p.k., me identietin e te cileve u njoha konform ligjit,madhore,me zotesi te plote juridike per te veprуar te cilet deklaruan se statuti i redaktuar jashte kesaj zyre,shpreh vullnetin e tyre te lire, i cili pasi u lexua u firmos para meje rregullisht.
Une noterja e nenshkruaj rregullisht kete akt.

N O T E R E

JONILDA ODRICANI

# AKT THEMELIMI

I SHOQERISE SE PERBASHKET "KUCOVA" PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE PRIVATE

Sot ne daten28.10.1997 ne te nenshkruarit Shezai barxha, i biri i Dajkos, Vasil Daka, i biri i Janit, Dashnor Mimani, i biri i Mimanit, Pellumb Veizi, i biri i Qaniut, Qani veizi, i biri i , Artan Vrusho, i biri i Tajarit, Skender Avdullai, i biri , Comen Nuhu, i biri iIljazit, Arben nuhu, i biri i Skenderit, Ilir Jaupi i biri i Haxhiut rane dakort per themelimin e shoqerise private per te ushtruar veprimtari "Transport Interurban udhetaresh dhe bagazhe te tyre" ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj ne keto kushte:

## NENI 1

Te dhjete themeluesit rame dakort qe shoqeria private qe krijojme te jete nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar SH.P.K. per te ushtruar veprimtari "Transport Interurban Udhetaresh dhe Bagazhesh".

## NENI 2

Shoqeria te kete emrin "KUCOVA".

## NENI 3

Kjo shoqate te kete seline e saj ne Kucove.

## NENI 4

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe me shume se 10 vjet.

## NENI 5

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar Shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te ketij akt themelimi te statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi.

Statuti i kesaj shoqate i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e saj.

## NENI 6

Themeluesit e Shoqerise pergjigjen ne baze te legjislacionit ne fuqi per detyrimet e shoqerise.

## NENI 7

Objekti i veprimtarise eshte transporti Interurban i Udhetareve dhe i bagazheve.,te tyre ne gjithe territorin e Republikes se Shqipèrise dhe jashte saj.

## NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100 000 (njeqind mije) leke

Lete investuar ne menyre te barabarte nga te gjitha ortaket themelues.

## N E N I 9

Shoqeria ka te çelur llogari bankare.

Per veprimtarine normale te Shoqerise çelet libri i llogarise ku do te kooperohet gjithe aktiviteti e shoqerise sipas dispozitave ne fuqi

## N E N I 10

Themeluesit dhe organet e shoqerise detyrojen te rua ne karakterin e fshehte te informacionit, informateve, te njohurive dhe te pervojes se shkembyer ose te realizuer ne kuadrin e shoqerise dhe pergjigjenpe shkeljen e mundshme te ketij detyrimi.

## N E N I 11

Organet e shoqerise jane

-Asambleja e ortakeve e cila perbehet nga themeluesit e shoqerise

-Administratori i cili eshte Hamza Çarxha.

Numri i votave per çdo ortak eshte i barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai ka ne shoqeri.

## N E N I 12

Te gjithe mosmarreveshjet qe nuk zgjidhen me bisedime do te zgjidhen ne rruge gjyqesore nga Gjykata e Rrethit Kuçove.

O R T A K E T

Shezai Çarxha

Dashnor Mimani

Vasil Deka

Pellumb Veizi

Geni Veizi

Artan Vrusho

Arben Nuhu

Osmen Nuhu

Skender Avdullai

Ilir Gjauri.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER JONILDA ODRIÇANI

KUÇOVE

Nr. 942 i vep.

## V E R T E T I M

Sot ne Kuçove me date 29.10.1997 para me e Noteres Jonilda Odriçani u paraqiten personalisht ortaket themelues te mesiperm , te panjohur prej meje, madhore, me identitetin e larteermendur te identifikuar konform ligjit, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet